



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1907 prot.

Tepelenë, më 19.09.2023

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË Z. TËRMET PEÇI

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë!

Ju njoftoj se ditën e enjte, më datë 21.09.2023, ora 10:00, në Sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tepelenë` (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 31.08.2023.
3. **Projektvendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Gusht 2023”.
4. **Projektvendim** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Gusht 2023”.
5. **Projektvendim** “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimin e buxhetit për periudhën 8 mujore 2023”.
6. **Projektvendim** “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 95, datë 25.11.2022 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2023”.
7. **Projektvendim** “Për miratimin e projekt-dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2024÷2026”.
8. **Projektvendim** “Për vend-parkimet në Bashkinë Tepelenë”.
9. Çështje të tjera.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Arben Gumeni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1907/1 prot.

Tepelenë, më 19.09.2023

Lënda: Njoftim për mbledhjet e Komisioneve të Përhershme të Këshillit Bashkiak.

**ANËTAREVE TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
DREJTORISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAZHIMIT FINANCIAR
DREJTORISË LIGJORE DHE SHËRBIME ORGANIZATIVE
DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË TERRITORIT
DREJTORISË SË ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORISË SË ARSIM, KULRURËS DHE KUJDESIT SOCIAL**

Ju njoftojmë se mbledhjet e Komisioneve të Përhershme për shqyrtimin e Projektvendimeve do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, më datë **20.09.2023, ora 12:30.**

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Arben Gumeni